

Metafizika dhe Morali

Revistë filozofiko-shkencore

Volumi 1 • Verë 2011 • Numër 1



FONDACIONI "RUMI"

Metafizika dhe Morali

Revistë filozofiko-shkencore

Volumi 1 • Verë 2011 • Numër 1

Drejtor: Seyed Amir Hossein Asghari.

Redaksia: Prof. As. Dr. Gjergj Sinani (kryeredaktor); Prof. Dr. Sokrat Amataj (redaktor & korrektor); Sabina Fejzullaj; Edlira Osmani.

Grafika kompjuterike: Shkëlqim Amataj.

Bordi këshillimor ndërkombëtar:

Prof. Dr. Ali Reza Arafi, Rektor i Universitetit Al-Mustafa, Iran.

Prof. Dr. Seyyed Husein Nasr, *Universiteti George Washington, SHBA.*

Prof. Dr. Sachiko Murata, *Universiteti Stony Brook, SHBA.*

Prof. Dr. William C. Chittick, *Universiteti Stony Brook, SHBA.*

Prof. Dr. Oskar Brenifier, *Instituti i Filozofisë Praktike, Francë.*

Prof. Dr. Sokrat Amataj, *Studiues, Universiteti i Tiranës, Shqipëri.*

Prof. As. Dr. Gjergj Sinani, *Universiteti i Tiranës, Shqipëri.*

Mexhid Yvejsi, *Studiues, Kosovë.*

Edin Q. Lohja, *Studiues & përkthyes, SHBA.*

Prof. Dr. Golam Reza Avoni, *Instituti Iranian i Filozofisë, Iran.*

Prof. Dr. Muzafar Ikbali, *Qendra për Islamin dhe Shkencën, Kanada.*

Prof. Dr. Shahram Pazouki, *Instituti Iranian i Filozofisë, Iran.*

Revista filozofiko-shkencore 'Metafizika dhe Morali' publikon në faqet e saj artikuj të studiuesve e hulumtuesve shqiptarë e të huaj, që sjellin risi në lëmin e shkencave filozofike, moralit, etikës e metafizikës. Artikujt duhet të shoqërohen me abstrakte e të mos kenë qenë botuar më parë. Ata mund të jenë në gjuhën shqipe ose angleze. Revista 'Metafizika dhe Morali' fiton të drejtën e autorit të artikujve që publikon, duke i njohur autorit të drejtën e botimit të tyre në organe të tjera, me kushtin që revista 'Metafizika dhe

Morali' të referohet si publikuesi i parë i tyre. Më shumë të dhëna për kriteret e paraqitjes dhe të dërgimit të artikujve për botim e për politikën e revistës mund të gjenden në faqen zyrtare të Fondacionit 'Rumi': www.fondacionirumi.com/revista.

Revista 'Metafizika dhe Morali'

E Përtremuajshme e Fondacionit 'Rumi', Tiranë.

Adresa: Autostrada Tiranë-Durrës, Fushë Mëzez - Kashar, Tiranë,
Shqipëri.

www.fondacionirumi.com

Kontakt e-mail: info.rumi@fondacionirumi.com

Metafizika dhe Morali

Revistë filozofiko - shkencore

Volumi 1 • Verë 2011 • Numër 1

Përmbajtja

Editorial	9
Intervista	
Intervistë me Prof. As. Dr. Gjergj Sinani	13
Artikuj shkencorë	
Prof. Dr. Muzafar Iqbal <i>Tradita Intelektuale Islame dhe Kriza Mjedisore</i>	23
Prof. Dr. Shahram Pazouki <i>Problem i Raportit Subjekt - Objekt në Filozofinë Islame: Zgjidhja e Mulla Sadra-it</i>	37
Prof. Dr. Seyyed Husein Nasr <i>Filozofia në Tokën e Profecisë: Filozofia Islame nga Origjina Deri në Ditët e Sotme</i>	45
Prof. Dr. William C. Chittick <i>Qëllimi i Jetës Filozofike</i>	61
Prof. As. Dr. Gjergj Sinani <i>Dasein dhe Qenia e Vërtetë Sipas Aristotelit</i>	73
Seyed Amir Hossein Asghari <i>Shkenca e Teknologjia Moderne në Këndvështrimin e Shkollës Filozofike Tradicionaliste të S. H. Nasr</i>	83

Dr. Mirela Sinani <i>Nga Erosi Sokratik te Besimi i Kirkegardit dhe Marrëdhënia e Tyre me të Vërtetën</i>	97
Prof. Dr. Sokrat Amataj <i>Shkenca në Fokusin e Filozofisë e Fesë Islame</i>	115
Martin Haideger <i>Kush është Zarathustra i Niçes?</i>	125
Mexhid Yvejsi <i>Filozofia dhe Zhvillimet Bashkëkohore</i>	151
Aktivite shkencore	
Seminari Ndërkombëtar 'Filozofia dhe Shkenca në Kulturën Perëndimore dhe Atë Lindore'	165
Botime	
Libra të botuara e për t'u botuar nga Fondacioni 'Rumi'	169
Ftesë për punime	
Call for papers	180
Abstraktet në gjuhën angleze	
Abstracts	182
Editorial persisht	188

Qëllimi i Jetës Filozofike.⁴⁰

Prof. Dr. William C. CHITTICK.⁴¹

Abstrakt

Nuk ka dyshim që qeniet njerëzore zotërojnë forcën e inteligjences. Që të mohohet një gjë e tillë në ndonjë farë mënyre a rruge, që e ka një farë kuptimi, duhet kundërshtuar vetvetja. Duke u nisur nga fakti që njerëzit e kanë këtë forcë, ata mund ta përdorin atë siç e shikojnë të përshtatshme. Por kjo nuk do të thotë që mënyra se si e përdorin është e parëndësishme e që çdo gjë do të shkojë mirë pashmangshmërisht. Ashtu si kanë nevojë për disiplinë e udhëzim që njerëzit të bëhen pianistë apo lojtarë futbollit, ashtu kanë nevojë edhe për disiplinë e drejtim që të realizojnë plotësinë e intelektit, që do të thotë të arrijnë plotësinë e qenies njerëzore; dhe kjo, sepse vetëm inteligjenca është karakteristikë unikalisht njerëzore.

Fjalë kyçe.

Filozofia, qenia, njohja e vetvetes, wujud, kozmologjia islame, kozmosi.

Parimi i Delfit “Njih vetveten” përmbledh ndofta më mirë se çdo shprehje tjetër thelbin e jetës filozofike. Të gjithë filozofitë që e meritojnë të quhen kështu, duhet të kenë në qendër të tyre kërkesën për vetë-njohje, sepse filozofia e vërtetë mbetet sigurisht e paarritshme për ata që nuk e njohin veten. Me fjalë të tjera, kush heton e mëson gjëra që nuk hedhin dritë mbi kuptimin e vetes së vet, thjesht e humbet kot kohën e vet.

Dihet që filozofët muslimanë në përgjithësi kanë gjithnjë parasysh një synim praktik. Ata janë dashurues të dijeve që kanë për qëllim që të njohin ekzistencën në vetvete, dhe, duke e njohur ekzistencën, të njohin dhe të gjitha gjërat që ekzistojnë. Por, të kuptosh *wujud-*

⁴⁰ Përkthyer nga Prof. Dr. S. Amataj.

⁴¹ Universiteti Shtetëror i New York-ut.

in⁴² në tërësinë e tij është e njëjtë si të kuptosh njohjen e vetvetes në tërësinë e saj. “Të jesh” në kuptimin e plotë të fjalës është që të kesh një vetëdijesim total. Qenia absolute është njohja absolute. Filozofi përpiqet që ta njohë *wujud*-in si *wujud*, por ai mund ta bëjë këtë vetëm duke njohur vetveten si vetvete. Me fjalë të tjera, filozofi përpiqet që ta njohë intelektin si intelektor⁴³ ose ta njohë inteligjencën e tij të pastër e të lirë (*mujarrad*) si të vetmin objekt të vërtetë të dijes. Ky është stadi i unifikimit të intelektorit, intelektit e të së intelektuarës⁴⁴, pozicion ky që ndër filozofët muslimanë është hulumtuar në mënyrë më të plotë nga Mulla Sadra.

Rrjedhimisht, qëllimi praktik i filozofit është që të njohë të gjitha gjërat. Por, që t’i njohë të gjitha gjërat, filozofi duhet të njohë principin e të gjitha gjërave, një princip që është, në të njëjtën kohë, njohësi i gjithë gjërave dhe plotësia e qenies. Ky njohës është “intelekti”, që është vetja e bërë plotësisht realitet, ose vetja që është plotësisht e vetëdijshme për vetëveten, ose, siç e quan ndonjëherë Baba Afdal, *rrezatimi i Ipseity*⁴⁵ (*furugh-i huwiyya*).

Në plotësinë e realizimit të tyre, vetja dhe ekzistenca janë që të dyja identike. Në të dyja ka një shpalosje të qartë nga më e ulëta - niveli i pajetë, e deri në më të lartin - niveli i vetëdijes për veten, që është intelektit i realizuar plotësisht, ku ekzistenca dhe qenia i vetëdijshëm janë një. Këtë del se që të dyja disiplinat, psikologjia dhe ontologjia, fokusohen në ngjitjen nga potencialiteti në bërjen realitet i plotë.

Por, pikë së pari pyetet: Si vinë gjërat në ekzistencë në gjendje potencialiteti? Gjatë diskutimit të Rikthimit, filozofët muslimanë kanë trajtuar imtësisht intuitën bazike njerëzore, duke sjellur kontribute

⁴² Fjalë arabisht që zakonisht përkthehet ekzistencë, qenie, prani, entitet. Në kontekstin islam, ajo përkthehet më shumë ‘që është gjetur’, dhe merr një kuptim më të thellë dhe nuanca të ndryshme. Për shembull, thuhet që çdo gjë e përfton *wujud*-in e vet kur gjendet ose perceptohet nga Zoti. Në traditën Sufiste, termi *wujud* i referohet më shumë gjetjes së Zotit se sa ekzistencës së Zotit. (Përkthyesi).

⁴³ Përdorues ose disponues i intelektit. (Përkthyesi).

⁴⁴ Asaj që është objekt njohjeje nga intelektit ose që është trajtuar nga intelektit. (Përkthyesi).

⁴⁵ Uni, vetja, individualiteti, identiteti individual (nga latinishtja *ipse* që do të thotë ‘vetja’). (Përkthyesi).

të shquara. Njerëzit e dinë për së brendshmi⁴⁶ që janë "ngjitur lart" dhe që mund të vazhdojnë të ngjiten edhe më shumë. Njeriu i rritur ka dalë prej fëmijërisë së tij, fëmija prej barkut të nënës dhe njeriu i mësuar nga injoranca. Njerëzit mund ta ndihmojnë kacavarjen e tyre drejt lartësive me anë të vetë përpjekjeve të tyre. Ata mund të kacavirren për tek majat duke përdorur dhuntitë dhe talentet e tyre dhe mund t'i vendosin qëllimet e tyre aq lart sa dëshirojnë vetë. Gjithë konceptet e mësimit, edukimit, përmirësimit, përparimit, evolucionit e zhvillimit të orientuar mbështeten në këtë kuptim fundamental: Gjërat mund të ndryshohen në kahun që synon për sipër. Kjo ide është kaq bazike për jetën njerëzore, sa rrallë herë njerëzit merakosen për të menduar rreth saj, por e marrin thjesht si diçka krejt të natyrshme. Në termat mitike të monoteizmave perëndimore, pikësnyimi drejt të cilit orientohet lëvizja që synon për sipër korrelohet, ndër të tjera, me sferat qiellore plot yje dhe me Parajsën apo domenin e lumturisë pas vdekjes, ndërsa mospranimi për të ndërmarrë lëvizjen në drejtimin që synon për sipër lidhet me sferat më të ulëta të ekzistencës dhe me Skëterrën.

Filozofët e diskutojnë lëvizjen rikthyese ngjitesë në terma të ontologjisë e psikologjisë, kurse lëvizjen e drejtuar për poshtë, që të rikthen në pikën ku ka nisur rruga, e diskutojnë më shpesh në terma të kozmologjisë. Pyetja është kjo: Nga ka ardhur kjo botë dhe si ka ndodhur që ne jemi këtu? Në përgjigjen ndaj kësaj pyetjeje, filozofët operojnë me intuitën, e cila për njerëzimin para-modern është po aq themelore sa perceptimi i lëvizjes që synon ngjitje. Pikë së pari ajo na thotë se asgjë nuk mund të lëvizë për sipër pa pasë zbritur poshtë më parë. Siç e shpreh Baba Afdal përmbledhtas, 'nuk ngrihet nga toka asgjë që nuk ka rënë nga qielli'⁴⁷.

Tani ne ndodhemi poshtë e provë e kësaj është fakti që aspirojmë për gjëra më të larta, që shpesh herë edhe i arrijmë. Po nëse ne jemi poshtë tani, kjo aspiratë e jona duhet t'i korrespondojë diçkaje brenda nesh, që e di se çdo të thotë të gjendesh lart. Dija e vërtetë e sipërisë presupozon një lloj vetëdije të mëparshme lidhur me çfarë është të qenët sipër, dhe kjo do të thotë, nga ana e saj, që diçka duhet të na ketë zbritur që prej andej sipër.

⁴⁶ Si të lindur bashkë me ta, në mënyrë të vetvetishme. (Përkthyesi).

⁴⁷ Cituar në Chittick, 'The Heart of Islamic Philosophy', 206.

Formulimet mitike të sipërisë së fillimshme janë universale, në fakt. Mitet shkencore të evolucionit dhe progresit mund të jenë të vetmit shembuj të miteve që flasin për lëvizjen për sipër, ndërkohë që e mohojnë zbritjen e fillimshme. Në mitet moderne, ne e vendosim veten në majë dhe shohim fundin që kemi lënë pas. Alfa është një gjë që është shumë prapa dhe poshtë nesh, kurse ne jemi tek omega, apo, të paktën, tek omega aktuale. Në mitet paramoderne, njerëzit e shikonin veten si një pikë që ka nisur një trajektore diku atje lart, me Zotin ose zotërit. Rrjedhimisht, qeniet njerëzore kanë rënë poshtë dhe tani janë në procesin e rikthimit mbrapsht, sipas drejtimit nga i cili erdhën. Alfa e omega janë e njëjta gjë, në fund të fundit.

Disa versione të mitit modern sugjerojnë se ky proces është i pashmangshëm e ne jemi detyruar të ngjitemi lart për shkak të ligjeve objektive të evolucionit dhe se do të vijojmë të ngjitemi më lart, sa kohë që do të evoluojmë më tej. Por mitet para-moderne nuk flasin për ngjitje të garantuar, të paktën jo për çdo lloj të ardhmje që e ka njëfarë kuptimi. Nëqoftëse duhet të ketë një ngjitje për lart, njerëzit duhet të përpiqen ta arrijnë vetë. Ne mundemi të lëvizim me lehtësi larg prej Realitetit Përfundimtar, ashtu siç mund të lëvizim edhe më pranë tij. Ne mund të mbetemi pafundësisht në hallakatje e shumëtrajtshmëri. Madje edhe versionet e miteve para-moderne, që flasin për një rikthim të pashmangshëm të një Zot i veçantë e i dashur, si mitet islame, këmbëngulin që qeniet njerëzore duhet të përpiqen me vetë fuqitë e tyre, nëqoftëse duan të rikthehen nëpërmjet një rruge që do t'i lërë të lumtur në përfundim të udhëtimit. Nëqoftëse ata nuk janë të gatshëm që të kacavirren për lart, do të kthehen mbrapsht në mënyrë të detyrueshme dhe do të vuajnë për shkak të mungesës së harmonisë dhe ngjashmërisë me çfarë takojnë rrugës dhe pasi të kenë mbërritur në destinacion.

Arsyeja themelore, që qëndron në bazë të miteve paramoderne, është perceptimi i cilësive të padukshme tek bota dhe tek vetja, që është të kuptuarit që në ekzistencë ka më shumë se ç'mund të shikojë syri, e kjo - jo në terma të pamjaftueshmërisë fizike, po në terma të distancës spirituale. Të gjitha mitet pranojnë një sferë të gjërave superiore, të qarta dhe inteligjente, që mund të shikohen nëpërmjet bukurisë dhe mirësisë që gjejmë tek vetja e tek bota. Ne duhet të synojmë lart drejt kësaj sfere, nëse duhet ta aksesojmë.

Ata që e synojnë atë sferë me sinqeritet, dashuri dhe devocion, e arrijnë në mënyrë më të plotë se ata që përfshihen sa për formë, apo se ata që nuk bëjnë asnjë përpjekje për t'iu futur një udhëtimi të tillë. Me pak fjalë, bota perceptohet si e mbushur me cilësi hyjnore, ndërkohë që vetja njerëzore e plotë dhe e shëndetëshme kuptohet si ajo që tërhiqet në drejtim të atyre cilësive, që janë burimi i gjithë vetëdijes dhe i çdo gjëje që është e mirë, e bukur, e dëshirueshme dhe e dashurueshme.

Shpjegimi i arsyeshëm i miteve moderne duket se është paaftësia për të shikuar cilësinë përtej sasisë. Të gjitha të ashtuquajturave 'cilësi', nëse janë reale në ndonjë farë mënyre, u jepet një shpjegim i nxituar në terma reduksioniste⁴⁸ dhe sasiore. Me anë të ndarjeve të paqarta e të analizës – duke i kthyer gjërat mbrapsht deri te geni, pozicioni shoqëror ose grimca atomike – mund t'ju jepen shpjegime të nxituara e shkel-e-shko gjithë jehonave të hyjnore, të cilave u vishen përherë cilësime të tilla si 'primitive' apo 'qenie të prapambetura'. Vetë ne e vëme veten pastaj në një pozicion të privilegjuar në majë të ngjitjes së shpejtë evolucioniste. Në fund të fundit, vetëm ne e kemi aftësinë për të kapur të vërtetën që është prapa kozmosit ose, – atë që në ditët e sotme duket si më e lakuar, – faktin që prapa kozmosit nuk ka asnjë të vërtetë.

Me pak fjalë, perceptimi i cilësisë lejon që njerëzit t'ju shikojnë gjërat si ekrane të tejdukshme, ku shfaqen shenjat e Zotit, ndërkohë që paaftësia për të parë gjë tjetër përveç sasisë, nxit një farë të menduari që kupton vetëm në terma reduktimi tek ca emëruesat më të vegjël të përbashkët.

Për të menduarit islamik në përgjithësi, njohja e sferës cilësore, për ku aspirojmë, kërkon që të njohim domenin cilësor, nga i cili na kanë zbritur aspiratat. Kush e do bukurinë, e aspirojnë sepse e ka sensin e asaj çfarë do të thotë ajo, madje ky sens mëkohet tek i njëjti burim si edhe vetë bukuria. Por që të gjendet pika për ku synojmë, duhet njohur në radhë të parë rruga, nga e cila na ka zbritur kjo aspiratë. Baba Afdal e shpjegon këtë çështje në një letër dërguar një nxënësi të tij:

⁴⁸ Prirje për të shpjeguar një tërësi komplekse faktesh, entitetesh, dukurishë e strukturash me një tërësi të thjeshtësuar faktesh, entitetesh, etj. (Përkthyesi).

Duhet të dish që kërkimi e eksplorimi i gjërave si dhe studimi i Origjinës dhe i Rikthimit të vetes, nuk buron nga individë të kësaj bote. Nëse kërkimi dhe dëshira e zjarrtë për kuptimet e rrugën e realitetit do të buronin nga individë njerëzorë thjesht sepse janë individë, ky problem do të takohej tek çdo individ i veçantë, gjë që nuk ndodh; dhe kjo, sepse dëshira për të përfshirë të dyja botët i përshtatet dikujt, i cili e ka mundësinë që t'i përfshijë. Por është e pamundur që çdo individ, i veçantë në pikëpamje të individualitetit, të përfshijë një tjetër individ, pa le më pastaj të dyja botët. Kështu pra, kjo dëshirë nuk buron nga individët. Ajo lind më shumë nga vetja që ndriçohet nga drita hyjnore.⁴⁹

Filozofët e kanë studiuar Origjinën me qëllim që të kuptojnë Rikthimin. Origjina dhe Rikthimi përfaqësojnë dy lëvizjet bazike, që kërkon *tawhid*-i - pohimi i Njëjesisë së Zotit. Pohimi që Realiteti Fundamental është vetëm Një kërkon që të pranohet se Ai është edhe i Pari (*awwal*), edhe i Fundit (*akhir*). Çdo gjë vjen nga i Vërteti dhe çdo gjë rikthehet tek Ai. Për të kuptuar si do të rikthehemi tek i Pari, duhet të zbulojmë si ndodhi që erdhëm duke u ndarë prej të Parit. Për ta bërë këtë, duhet të kuptojmë natyrën e vërtetë të aftësive dhe fuqive tona, duke përfshirë këtu inteligjencën e ndijimet. Lind nevoja, po ashtu, që të pyetet nëse rikthimi i detyrueshëm tek i Pari, që është faktori që na shpie në fakt në vdekje, është i mjaftueshëm për të arrirë humanitetin e vërtetë, ose – gjë që duket të jetë më e mundshme, nëse nuk është e vetdëshmueshme – nëse na duhet të përdorim fuqitë tona njohëse dhe praktike për ta arritur këtë humanitet, ashtu siç i përdorim këto fuqi për të arritur gjithshka tjetër që mund të arrijmë.

Filozofët muslimanë e konsideronin studimin e vetes njerëzore me rëndësi fundamentale për 'kërkimin e urtësisë', që është, në fakt, përkufizimi i filozofisë. Ata kërkuan në radhë të parë për rrënjët e vetë vetes. Ata e konsideronin etikën një shkencë të rëndësishme, sepse etika nuk është tjetër, veçse reflektim për faktin se si vetja e arrin harmoninë me të Parin në pajtim me mënyrën, me të cilën ajo erdhi nga i Pari fillimisht. Vetja u shfaq në botë për shkak të një zbritjeje

⁴⁹ Cituar në Chittick, 'The Heart of Islamic Philosophy', 150-151.

të detyrueshme, në kuptimin që askush nga ne nuk u pyet në donte të vinte apo jo. Ose, në dritën e qasjeve të caktuara neoplatonike, liria njerëzore (*ikhhtiyar*) ishte tashmë e shfaqur në zgjedhjen e vetes njerëzore për të ardhur në këtë botë. Pavarësisht nëse ne e zgjodhëm që të vinim apo jo, ne kemi ardhur e tani na duhet që të kthehemi mbrapsht atje, prej nga erdhëm. Ne kemi liri të mjaftueshme për të bërë disa zgjedhje dhe liria që kemi duhet përdorur për më të mirën, nëse duhet synuar vërtet një mundësi për arritjen e lumturisë përfundimtare. Filozofët thonë se, në gjendjen e tyre të tanishme, qeniet njerëzore janë në procesin e ngjitjes sipër, që do të thotë se ato janë duke u zhvilluar nga mundësitë që fsheh një vezë e fekonduar drejt aktualizimit të pastër të intelektit të lirë (*mujarrad*). Për shkak të rikthimit të detyruar, ato bëjnë njësh në vetvete fazat e natyrës minerale, të vetes bimore e të vetes shtazore dhe zotërojnë fuqitë e aftësitë e të gjitha këtyre stadeve. Tani ato qëndrojnë në nivelin e vetes njerëzore, kështu që janë të lira ta drejtojnë vetë kahun e ngjitjes së vetes së tyre. Askush nuk i detyron ato që të vazhdojnë lëvizjen për lart. Nëse preferojnë të veprojnë ndryshe, ato mund të qëndrojnë aty ku janë e të vërtiten duke perfeksionuar vetitë shtazore në një shkallë të paëndërruar më parë nga kafshët e tjera jo-njerëzore.

Nuk ka pikë dyshimi që qeniet njerëzore kanë forcën e inteligjencës. Të mohosh një gjë të tillë në ndonjë farë mënyre a rrugë që e ka një farë kuptimi, duhet të kundërshtosh vetveten. Ndërkaq, fakti që njerëzit e kanë këtë forcë, sugjeron që mund ta përdorin siç e shikojnë të përshtatshme. Por kjo nuk do të thotë që mënyra si e përdorin është e parëndësishme e që çdo gjë do të shkojë mirë pashmangshmërisht. Ashtu si njerëzit kanë nevojë për disiplinë e udhëzim që të bëhen pianistë apo lojtarë futbollit, ashtu kanë nevojë edhe për disiplinë e drejtim që të realizojnë plotësinë e intelektit, që do të thotë të arrijnë plotësinë e qenies njerëzore; dhe kjo, sepse vetëm inteligjenca është karakteristikë unikalisht njerëzore.

Nuk dua që të sugjeroj me këtë se inteligjenca është e vetmja karakteristikë e tyre njerëzore: Ajo është më shumë tipari njerëzor më suprem, ajo është maja e mundësisë njerëzore, për vetë faktin se plotësia e inteligjencës është identike me vetë plotësinë e qenies. Megjithatë, ndofta ka nevojë të theksohet se vetja ka dy përsosmëri, teoriken dhe praktiken, dhe se të dyja ato kanë nevojë të aktualizohen.

Përsosmëria praktike kërkon plotësinë e qenies etike dhe morale ose aktualizimin e virtuteve (*fada'il*). Po as përsosmëria teorike dhe as ajo praktike nuk mund të arrihen në izolim. Përsosmëria e inteligjencës nuk mund të arrihet pa përsosur tërë dhuntitë e vetes, më të shumtat e të cilave emërtohen me emra virtutesh si dashuria, dhembshuria, drejtësia, ndjesa. Aktiviteti etik dhe tiparet e bukura të karakterit janë të pandashme nga përpjekja për statusin njerëzor.

Për të lëvizur nga intelektu potencial tek intelektu ekzistues, njerëzit kanë nevojë të dinë për çfarë përpiqen. Në përgjithësi tradita religjioze kërkon që ta gjejë dijen e synimit përfundimtar në Kuran dhe Hadith, ndërsa dijen e praktikës që lejon të arrihet ky synim, përpriqet ta gjejë në Sunnah dhe Sheriat. Por filozofët mbrojnë tezën se dija e synimit përfundimtar dhe e praktikës që nevojitet për arritjen e tij kërkojnë mendim dhe reflektim. Njerëzit e aktualizojnë inteligjencën dhe zhvendosen hap pas hapi nga intelektu potencial te intelektu plotësisht i aktualizuar në proporcion me masën e përdorimit të fuqisë së intelektit që zotërojnë për të kuptuar natyrën e gjërave.

Diskutimet filozofike të Rikthimit përqëndrohen në dy rrugë bazike të kthimit mbrapsht tek i Pari: Në rrugën që njerëzit do të detyrohen të ndjekin, dhe në rrugën që ata janë të lirë të ndjekin, nëse zgjedhin të veprojnë në këtë mënyrë. Diskutimet e Origjinës fokusohen në faktin se si kanë ardhur njerëzit në vijën e tyre të startimit. Nëqoftëse ata mund të ngjiten deri tek inteligjenca, duhet të kenë ardhur nga poshtë, që nga inteligjenca. Nëqoftëse ata mund të ngjiten te inteligjenca duke u ngjitur nëpër stadet e vetes, duhet të kenë ardhur në këtë botë duke zbritur nëpër stadet e vetes. Rikthimi është imazh i pasqyruar i Origjinës.

Itinerari zbritës i Origjinës njihet mirë. Skema bazike është e njëjtë me atë që tashmë është e dëshmuar në Neoplatonizëm – intelektu, vetja, sferat qiellore, katër elementet. Baba Afdal i përmbahet më të thjeshtës së skemave, por ka edhe filozofë që kanë kaluar nëpër disa faza, siç janë al-Farabi dhe Avicena.

Sidoqoftë, gjuha e këtyre diskutimeve nuk duhet të na nxjerrë jashtë teme dhe të mendojmë se, për shembull, filozofët po i materializojnë konceptet e intelektit dhe të vetes, ashtu si po materializojnë sot

njerëzit konceptin e Zotit e ashtu si janë duke përshkruar planetet dhe sferat qiellore me diçka që u përgjigjet shqetësimeve të astronomisë moderne. Diskutimet lidhur me intelektin dhe veten duhet të kenë të bëjnë me atë që mund të rigjurmohet në vetë vetet tona, kurse diskutimet e sferave duhet të merren me çfarë mund të shquhet me sy zhveshur. Duke studiuar qiejt, filozofët kërkojnë të dinë se çfarë mund të mësojmë për atë që është *sipër* duke shikuar në atë kah. Sipëria e domenit fizik është analoge e sipërisë së domenit spiritual, që do të thotë se ajo që është *sipër* në terma të perceptimit tonë shqisor është shenjë e realiteteve që janë *sipër* në raport me inteligjencën dhe kuptimin tonë. Nëse ne shikojmë lart në botën e jashtme, ne shikojmë planetet dhe yjet, e nëse shikojmë lart në botën e brendshme, ne shikojmë veten dhe inteligjencën. Çelësi mbetet shikimi, vrojtimi, mendimi, reflektimi, peshimi, meditimi, soditja.

Me pak fjalë, diskutimi i qiejve i përket studimit të cilësive dhe karakteristikave që janë *më sipër* se ç'jemi ne në natyrën tonë trupore, pa qenë të tilla në natyrën tonë mendore. Për aq sa qiejt kanë të bëjnë me Origjinën, ata paraqesin stadet zbritëse, nëpërmjet të cilave vetja, duke zbritur nga Intelekti dhe duke u futur në mitër, bëhet gjithmonë e më e diferencuar nga vetet e tjera dhe gjithmonë e më shumë e ekspozuar ndaj shumëformshmërisë. E për aq sa qiejt kanë të bëjnë me Rikthimin, ata paraqesin stadet, nëpër të cilat duhet të kalojë vetja në mënyrë që të aktualizojë potencialitetin e saj, të harmonizojë forcat e saj të ndryshme, të unifikojë aftësitë e saj të shumëllojshme e t'i ribashkohet Intelektit, nga i cili erdhi. Modeli mitik i këtij Rikthimi gjendet në rrëfimet rreth *mi'rajit*⁵⁰ të Profetit.

Filozofët e zhvilluan aftësinë për të lexuar domethënien spirituale nga çfarë shihnin në sferat qiellore, sepse kjo i bënte të meditonin rreth vetëvetes. Ata panë që vetë ata, duke filluar që nga mitra, janë ngjitur nga minerali tek bima, kafsha, njerëzorja, dhe se tani janë në fazën e përpjekjes për t'u ngritur në plotësinë e vetë-njohjes, tek intelektin që njeh vetveten dhe të gjitha gjërat. Në vështrimin e tyre,

⁵⁰ Në arabisht do të thotë *shkallë*. I referohet një prej dy fazave të udhëtimit fizik e spiritual të Natës që Profeti Muhamed tregohet të ketë bërë rreth vitit 621. Kjo fazë i përgjigjet udhëtimit të Profetit nga Xhamia al-Aksa në qiej, ku takon profetët e lashtë dhe Vetë Zotin. (Përkthyesi).

rruga për të arritur një njohje me të vërtetë të dobishme të sferave – pra, të dobishme në kërkimin për t’u bërë njerëzorë – është të hetohet se si sfera qiellore manifeston cilësitë dhe karakteristikat e natyrës sonë mendore. Të studiosh qiejt është të studiosh realitetet që bashkojnë shumë realitete të tjera dhe përfshijnë e rrokin botën kalimtare këtu poshtë. Qiejt e reflektojnë shumë më drejtpërdrejt se sa sfera tokësore natyrën e vetes inteligjente, e cila është e pakorruptueshme dhe e përjetëshme.

Kur lexohen diskutimet historike të kozmologjisë islame, ndonjëherë krijojnë përshtypjen që Intelekti i Parë e Vetja Universale – pra, stadet e para të zbritjes nga Origjina – ishin koncepte që u morën pa menduar shumë nga burimet Neoplatonike. Të dyja ato mund të duken supozime pak a shumë të çuditshme, që nuk kanë fare lidhje me botën reale – ndonëse është e kuptueshme që mund të bëheshim të besonim që muslimanët konformistë, të cilët mbështeten si zakonisht te grekët, duhej ta huazonin këtë nocion si një shpjegim të lehtë e gjoja *racional* të origjinës së Universit. Por s’ka asnjë arsye që të mendohet se këto ide u pranuan pa u asimiluar në mënyrë kritike nga ana e atyre që i morën. Filozofia nuk është asgjë, nëqoftëse nuk është konsiderim i ftohtë i asaj që mund të njohim dhe ndarje e supozimit prej dijes së vërtetë. Ajo është më shumë një lloj historiani që i sheh idetë si të ishin artifakte të çmuara, e historinë e tyre - si manual të sipërfaqshëm të ideve në të shkuarën.

Nëqoftëse duhet t’i japim Intelektit e Vetes një kuptim - si paraardhës të dyfishtë të kozmosit, duhet të ndalemi e të mendojmë për atë që përpiqeshin të thoshnin filozofët. Si qenie njerëzore, ne dimë së brendshmi se të gjitha gjërat kanë lindur nga Vetja, për faktin se vetë vetet tona e përfshijnë natyrën bashkë me aftësitë bimore, shtazore e humane. Ne dimë vetvetiu, gjithashtu, se Intelekti është Origjina Gjithëpërfshirëse dhe se është pikërisht inteligjenca jonë ajo që e di të gjithë këtë, e sistemon të gjithë këtë, shkon me gjithë këtë dhe e përfshin të gjithë këtë. Nëse inteligjenca jonë mikrokozme është e aftë që ta imagjinojë të gjithë botën, mund ta bëjë një gjë të tillë sepse është, tashmë, në një farë niveli të vetvetes, një inteligjencë që e imagjimon të gjithë universin. Para së gjithash, ajo që ngrihet sipër duhet të ketë zbritur poshtë më parë.

Në vend që të heqim dorë nga mësimet e kozmologjike islamike, nga që nuk akordohen mirë me strukturat kozmologjike, që janë sot në modë, ne duhet t'i bëjmë vetes këtë pyetje: Cili është qëllimi i studimit të universit? Cilat janë caqet që i kanë vënë vetes ata që e studiojnë? Një gjë është tashmë e sigurt: Qasjet korrente të studimit të universit dhe teoritë që i shoqërojnë falimentojnë që të gjitha qysh në sipërfaqe të realitetit, ndërkohë që kozmologjia Islame ka qenë gjithmonë e interesuar për thellësitë e realitetit; dhe thellësitë e realitetit janë të pandashme nga vetja njerëzore.

Sot studimi i vetes njerëzore është braktisur. Në vend të kësaj, njerëzit studiojnë subjekte që u lejojnë të gjejnë rrugëdalje dhe t'ia dalin mbanë ose që të bëjnë pare, të paktën. Për filozofinë islame, të braktisësh studimin e vetes është të braktisësh *qenien njerëzor* si dhe të heqësh dorë nga çdo pretendim për statusin e *njeriut*. Dija që nuk na ndihmon dot të kuptojmë se kush jemi, nuk është dije, në fakt. Teoritë që pretendojnë të japin dije që kanë hequr dorë nga njohja e subjektit, janë thjesht injorancë e ngritur në sistem. Këto teori mund të jenë shumë të dobishme për të manipuluar botën dhe për të vendosur raporte midis forcave, por nuk mund ta ndihmojnë dot kurrsesi kërkimin e urtisë.

Në këndvështrimin e filozofisë islame në përgjithësi, të jesh njerëzor është të kërkosh dije që na e shtojnë humanitetin. Tipar dallues i humanitetit është inteligjenca e vetëdijshme e vetëdija që inteligjenca kërkon në mënyrë inteligjente dhe të vetëdijshme të përqëndrojmë të gjitha energjitë drejt njohjes së vetvetes. Fruti i dijeve që nuk ndihmojnë në kërkimet për vetë-njohje, mund të jetë vetëm degradimi dhe shkatërrimi i natyrës njerëzore.